

Emri i lëndës	E DREJTA E TREGTISË DHE PUNËS	Shifra	105
Programi i studimit	EKONOMIA AFARISTE	Viti	1
		Statusi i lëndës	<input checked="" type="checkbox"/> e obliguar <input type="checkbox"/> zgjedhore
Qëllimet e lëndës	Për të njohur studentët me konceptet dhe logjikën bazë të tregtisë dhe të drejtës së punës njohja e të cilës është supozim për bisedime dhe lidhje kontratash të suksesshme me subjekte, struktura e drejtë e së cilës është e njohur dhe njohja e së cilës është kusht për zhvillimin e disa punëve afariste, si dhe njohuri themelore për të drejtat dhe obligimet e punëmarrësve dhe punëdhënësve.		
Përmbajtja e lëndës	Hyrje në të drejtën e punës. Konceptet bazë të cilat kanë të bëjnë me raporte obliguese (domosdoshmëri për lidhje kontratash, vlera e kontratës, ndryshimet dhe ndërprerjet e raporteve obliguese). Kontratat më të rëndësishme të drejtës së tregtisë (shitja, huazimi dhe krediti, qiradhënia dhe qiramarrja, përfaqësimi , komisioni , ndërmjetësimi, deponimi, licenca, etj.) Letrat me vlerë. E drejta statusore e tregtisë, konceptet e përgjithshme: tregtari, ndërmarrja, shoqëritë tregtare, tregtari individual dhe zejtari, ortakëria, përfaqësimi, regjistri gjyqësor. Shoqëri tregtare publike, shoqëri komanduese, shoqëri aksionare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, shoqata ekonomike të interesit si dhe ndryshimet e rëndësishme statusore. Konceptet e të drejtës së punës, themelimi i marrëdhënies së punës, të drejtat dhe obligimet e punëtorit dhe punëdhënësit, ndërprerja e marrëdhënies së punës.		
Kompetencat globale dhe specifike	<p><u>Njohuritë:</u></p> <p>Arritja e njohurive për subjektet e afarizmave tregtare, strukturën e pjesëmarrësit në të drejtën e tregtisë dhe punës, përcaktimi, përshkrimi, shpjegimi, dallimi dhe krahasimi i atyre subjekteve, njohja e përbërësve të rëndësishëm të disa kontratave, përparësive dhe mangësive në situatat konkrete, shfrytëzimi i mjeteve për forcimin e kontratave, njohja e elementeve të rëndësishme gjatë bisedimeve dhe lidhjes së kontratave, si dhe klauzolare mbrojtëse etj., ndërsa në lëmin e të drejtës së punës njohja e dispozitave të punësimit, të drejtat e punëtorëve dhe ndërprerja e punës.</p> <p><u>Shkathtësitë:</u></p> <p>Aftësimi për bisedime të suksesshme, identifikimi besueshmërisë dhe i potencialeve ekonomike të bashkëbiseduesit, krahasimi me të tjerët, zgjedhja e partnerëve me të volitshëm për lidhjen e kontratës, të hartuarit e skicës së kontratës, përcjellja e realizimit të kontratës, kundërvënia për shkak të plotësimit jo të plotë, si dhe lidhja e kontratës për vepër dhe punë.</p>		
Format e zhvillimit të mësim	<input checked="" type="checkbox"/> ligjëratat	<input checked="" type="checkbox"/> seminarët dhe punëtoritë	<input type="checkbox"/> ushtrimet
	<input checked="" type="checkbox"/> konsultimet	<input type="checkbox"/> multimediat	<input type="checkbox"/> Interneti
	<input type="checkbox"/> detyrat e pavarura	<input type="checkbox"/> punimi mendor	<input type="checkbox"/> demonstrimet
	<input type="checkbox"/> laborator (praktikumi)	<input type="checkbox"/> mësimi në distancë	<input type="checkbox"/> _____
	Mësimi përfshin paraqitjen dhe analizimin e rasteve nga praktika (case study). Problemi i disa tërësive tematike do të shtjellohet me anë të shpjegimeve të seminareve të studentëve (grupeve) në bazë të detyrave të marra për përpunimin e tërësive tematike.		
Mënyra e vlerësimit të diturisë	Dituria e studenteve vlerësohet gjatë mësimëve të seminarit duke përcjellur punën e tyre. Vlerësimi i përfundimtar i diturisë bëhet në provim me gojë me qëllim të vlerësimit të kuptuarit e përmbajtjes së lëndës.		
Literatura obliguese	Vilim Gorenc : <i>Bazat e së Drejtës Tregtare Statusore dhe Kontraktuese</i> (botimi në shqip, KU Victory, Prishtinë, 2006)		
Literatura plotësuese	Sipas preferencave se bartësit të lëndës		

Vlerësimi me poenë (ECTS)					Semestri dimëror					Semestri veror			
	ECTS				5					0			
	Numri i orëve të mësimit sipas semestrit				60					0			
	ECTS	Pt	St	Vt	prPt	prSt	prVt	Σ_t	$\Sigma_t \times 15$	prI	PI	UI	Σ
	5	2	2	0	1	1	0	6	90	49	0	1	140
Mënyra e kryerjes së provimit	<input checked="" type="checkbox"/> provim me shkrim <input checked="" type="checkbox"/> provim me gojë												
Mënyra e përcjelljes së kualitetit dhe suksesit dhe aplikimi i tij	<p>Përcjellja e kualitetit dhe suksesit të përpunimit të lëndës do të kryhet në mënyrë kontinuele dhe atë në disa nivele me anë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përpunimit statistikor dhe analizës së rezultatit të provimeve (verifikimit lakores Gaussov-it-ndarja normale e suksesit, krahasimit dhe përcjelljes së rezultatit në provimet e gjeneratave të ndryshme, analiza e të kuptuarit të disa moduleve/metodave), pyetjeve në provime etj. • zhvillimit të anketave në mesin e studentëve, • evaluimit dhe vetevaluimit të profesorëve, • pyetësorit të vazhdueshëm (propozime për përmirësim) të paraqitur në web faqe (për studentë dhe për personelin arsimor), • rezultateve të arritura, shkallës së të kuptuarit dhe diturisë gjatë punimit të seminarit (studentët të cilët zgjedhin punimin e seminarit nga kjo lëndë), • rezultateve të arritura dhe shkallës së njohurisë gjatë punimit dhe mbrojtjes së punimit të diplomës (studentëve të cilët zgjedhin punimin e diplomës nga kjo lëndë) • analizës së raportit kualitativ të menaxherit si dhe • informatave kthyesë nga ana e studentëve të cilët tashmë kanë diplomuar, për shfrytëzimin e përmbajtjes së kësaj lënde në kryerjen e punëve me të cilat merren. 												